

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 208 / Prot. 6

Tiranë, më 18 . 02 .2019

URDHËR I BRENDSHËM

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, si edhe bazuar në sugjerimet e Bordit Drejtues, sipas procesverbalit me nr. Prot. 208 / Datë 15 .02.2019:

URDHËROJ

Miratimin e ngritjes së grupit teknik për konfidencialitetin me përbërjen si vijon:

- a) Kryetar – Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit;
- b) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Llogarive Kombëtare;
- c) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave Ekonomike;
- d) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave Sociale;
- e) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit;
- f) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave të Sektorit Real;
- g) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit;
- h) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit;
- i) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe çështjeve ligjore;
- j) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Projekteve;
- k) Anëtar - Drejtor i Drejtorisë së komunikimit dhe publikimeve.

2. Qëllimi i ngritjes së GTK

2.1 Qëllimi i ngritjes së GTK është të përgatisë udhëzimet/rregulloret e brendshme për stafin e INSTAT për të siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit në përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave, në mënyrë që të parandalohet përdorimi i të dhënave për qëllime jostatistikore apo zbulimi i paligjshëm i tyre. Të përgatisë/përditësojë propozimet për draft Politikën e Konfidencialitetit të INSTAT si dhe të marrë në shqyrtim të dhënat e përpunuara nga kërkuesit shkencorë.

3. Objekti i GTK

3.1 Objekti i GTK do të jetë përgatitja e udhëzimeve/rregulloreve të brendshme për Konfidencialitetin statistikor që do të ndiqen nga stafi i INSTAT dhe propozimi i tyre për shqyrtim nga bordi i drejtorëve;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Villazen Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300 www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

3.2 Përgatit draft Politikën e Konfidencialitetit të INSTAT dhe bën propozimin për shqyrtim nga bordi i dretjorëve;

3.3 Të marrë në shqyrtim si edhe të përgatisë një relacion shpjegues për KK për të dhënat e përpunuara nga kërkuesit shkencorë.

4. Mbledhja e GTK

4.1 GTK mblidhet çdo muaj.

4.2 GTK duhet të reagojë ndaj zhvillimeve dhe kërcënimeve të konfidencialitetit statistikor dhe të informojë KK në çdo rast.

4.3 Kur GTK e gjykon të nevojshme, mban minutat e takimit për çështje të cilat kanë nevojë për tu diskutuar dhe vendosur me KK.

5. Të drejta dhe detyra të GTK

5.1 GTK e ushtron veprimtarinë e tij duke u bazuar në mirëbesim dhe duke u udhëhequr nga parimet e etikës profesionale për të krijuar një vlerë të shtuar infrastrukturore për institucionin publik INSTAT.

5.2 Për hartimin dhe përditësimin e udhëzimeve të Konfidencialitetit statistikor, GTK ka të drejtë të kërkojë nga specialistët në varësinë e anëtarëve të grupit studimin e dokumentacionit si dhe të thërrasë për ndihmë specialistë të tjerë të INSTAT-it.

5.3 Si rregull, anëtarët e GTK do të jenë përgjegjës për dhënien e propozimeve dhe inpleteve të tjera për udhëzimet/rregulloren e Konfidencialitetit statistikor sipas specialitetit që kanë dhe për fushën që mbulojnë.

5.4 Kryetari i GTK koordinon punën e grupit dhe mbledh informacionin e duhur për hartimin e udhëzimeve/rregulloren e Konfidencialitetit statistikor.

5.5 GTK i propozon KK për versionet standard të software-ve që do të instalohen në kompjuterat e "Dhomës së sigurt".

5.6 GTK i propozon KK veprime përmirësuese për mbrojtjen e konfidencialitetit.

6. Afati i përmbushjes së detyrave të GTK

6.1 GTK e ushtron aktivitetin gjatë gjithë kohës që është në fuqi ky Urdhër.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300 www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Hyrja në fuqi

7.1 Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm

DELINA IBRAHIMAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: Helda Mitre Drejtore e drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazen Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300 www.instat.gov.al